REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 730/20
Datë/Datum. 19.10.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

IDA. Berat MARMULLAKU *Ekspert Shqyrtues Profesional / Teknik*	*Data e autorizimit të ekspertit* *09.10.2020*	*Data e dorëzimit të raportit* *19.10.2020*

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: **28.09.2020, OE "P.M.N." SH.P.K. - Prishtinë**, ka parashtruar ankesën me nr. **730/20**, kundër propozimit për dhënie të kontratës (Njoftimit mbi Vendimin e AK) ku është rekomanduar për kontratë: **"KADOLLI" SH.P.K.** lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Ndërtimi i Shtatores së Komandantit Adem Jashari"** me nr. të prokurimit: **617-20-4196-4-2-3** dhe nr. te brendshëm: **617-2020-053-423**, te iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KOMUNA SHTIME.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurën: **Konkurs Projektimi**
Lloji i kontratës: **Konkurs i hapur**
Vlera e parashikuar e kontratës: **70,000.00 Euro.**

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim:

- Njoftimi për konkurs te projektimit është bërë me datën 07.08.2020
- Procesverbali i Hapjes-koncept projekti është bërë me datën (28.08.2020)
- Njoftim për rezultatet e Konkursit te Projektimit (Koncept projekti) (04.09.2020)
- Procesverbali i hapjes-elektronik (dokumentacioni-çmimi) (09.09.2020)
- Vendimi i AK i datës (17.09.2020)
- Kerkese për qasje ne dokumente zyrtare (17.09.2020)
- Lejimi i Qasjes për datën 18.09.2020 (17.09.2020)
- Kërkesa për dokumentacion (18.09.2020)

- Ofrimi i Dokumentacionit te skanuar nga ana AK (18.09.2020)
- Kërkesa për rishqyrtim (22.09.2020)
- Njoftim për pezullim nga AK (22.09.2020)
- Vendimi për refuzim te kërkesës për rishqyrtim (23.09.2020)
- Kerkese për koncept-projekt (25.09.2020)
- Ofrimi i dokumentacionit te koncept projektit (25.09.2020)

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues, i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2. PRETENDIMET ANKIMORE

Sa i përket pretendimeve të OE ankuesit:

Pas VLERSIMIT na dergohet :
Letra standarte per tenderuesin e pasukseshem me date **17.09.2020** po ne te njeten date ne eprokurimi tek dokumenti shtojca eshte bere edhe Njoftimi mbi Vendimin e AK –Titulli i kontrates se dhene nga AK kompanise **KADOLLLI SHPK** ne vlere prej **68,500.00 euro**

Me date **17.09.2020** kam kerkuar qasje ne dokumente zyrtare permes emajlit. Jam njoftuar nga AK qe te me krijohet qasja ne dokumenta zyrtare me date **18.09.2020 NE ORA 10** ku dhe jam shkuar. Kemi kerkuar te na dergohet Dokumentacioni

Gjate kontrollimit te dokumentacionit te kompanise fituese kam hasur ne shkelje te proceduarave nga AK ku nuk ka respektuar **:**

AK ka bërë shkeljet e dispozitave nga pika e mësipërme të cilat po i elaborojmë në vazhdim.

PRETENDIMI NR1

KERKESA NGA AK
Realizimi i shtatores kushtuar Heroit Kombëtar Adem Jashari sipas kërkesave të specifikuara:

-Shprehja figurative artistike e shtatores duhet të integrohet fuqishëm dhe të korrespondojë vizuelisht me hapësirën e sheshit në të cilin planifikohet të vendoset figura në bronzë;

- Shtatorja si koncept në vete duhet të jetë shprehje artistike dhe figurative me të cilën kjartë reflekton tiparet dhe personalitetin e Heroit Kombëtar Adem Jashari;

-Shtatorja duhet të rrisë vlerën e sheshit dhe të vihen në dukje elementet që shprehin vullnetin e Heroit Kombëtar Adem Jashari;

-Në konkurs pranohen punime individuale dhe grupore;

-Punimi nuk duhet të jetë pjesëmarrës në ndonjë konkurs tjetër apo të jetë ekspozuar në veprimtari të tjera të mëparshme të këtij lloji. Ai duhet të jetë i punuar enkas për këtë konkurs.

-Boceti i paraqitur nga konkurruesit si plastikë skulpturore duhet të jetë 60 cm i lartë, pa bazamentin;

realizim kreativ-artistik që korrespondon me kohën që nga pozicionimi dhe ndërtimi i figurës e deri në detajet e modelimit, siç janë portreti, duart, këmbët, veshja etj)

Konkurruesit -Artistët kanë të drejtë që të marrin pjesë në konkurs vetëm me një punim;

-Gjatë realizimit të veprës në madhësi reale, autori fitues i konkursit, nëse e ndjen të nevojshme, mund të bëj ndryshime minore artistike por që nuk shkojnë përtej zgjidhjes kompozicionale me të cilën ka fituar konkursin, duke marrë pëlqimin paraprak të komisionit.

Vërejtje: Variantet të cilat nuk respektojnë specifikat e vendosura - lartësia 60 cm, nuk do të merren parasysh, do të konsiderohen si konkurrime të pa përgjegjshme. Fituesi i kontratës obligohet që brenda 100 ditëve kalendarike nga dita e nënshkrimit të kontratës, ta sjell shtatoren dhe ta vendos në postament.

Në çmim duhet të kalkulohen të gjitha shpenzimet punimi i bustit, transporti, sigurimi gjatë transportit dhe vendosja në postament, realizuesi i shtatores duhet të shënoj-Gaveroj edhe Emrin Mbiemrin, datën e lindjes dhe te vdekjes.

DËSHMIJA 1

Boceti i paraqitur nga operatori ekonomik i shpallur fitues është 68cm i lartë, dhe si i tillë duhet të konsiderohet i papërgjegjshëm duke u bazuar ne kërkesën e mësipërme.




BREFIO
BREFIO
2408

PRETENDIMI NR 2

KERKESA NGA AK:

Realizimi i shtatores kushtuar Heroit Kombëtar Adem Jashari sipas kërkesave të specifikuara -Shprehja figurative artistike e shtatores duhet të integrohet fuqishëm dhe të korrespondojë vizuelisht me hapësirën e sheshit në të cilin planifikohet të vendoset figura në bronzë; -Shtatorja si koncept në vehte duhet të jetë shprehje artistike dhe figurative me të cilën kjartë reflekton tiparet dhe personalitetin e Heroit Kombëtar Adem Jashari; -Shtatorja duhet të rrisë vlerën e sheshit dhe të vihen në dukje elementet që shprehin vullnetin e Heroit Kombëtar Adem Jashari; -Në konkurs pranohen punime individuale dhe grupore; -Punimi nuk duhet të jetë pjesëmarrës në ndonjë konkurs tjetër apo të jetë ekspozuar në veprimtari të tjera të mëparshme të këtij lloji. Ai duhet të jetë i punuar enkas për këtë konkurs. -Boceti i paraqitur nga konkuruesit si plastikë skulpturore duhet të jetë 60 cm i lartë, pa bazamentin; realizim kreativ-artistik që korospodon me kohën që nga pozicionimi dhe ndërtimi i figurës e deri në detajet e modelimit, siq janë portreti, duart, këmbët, veshja etj) Konkuruesit - Artistët kanë të drejtë që të marrin pjesë në konkurs vetëm me një punim; -Gjatë realizimit të veprës në madhësi reale, autori fitues i konkursit, nëse e ndjen të nevojshme, mund të bëj ndryshime minore artistike por që nuk shkojnë përtej zgjidhjes kompozicionale me të cilën ka fituar konkursin, duke marrë pëlqimin paraprak të komisionit. Verejtje Variantet të cilat nuk respektojnë specifikat e vendosura - lartësia 60 cm, nuk do të merren parasysh, do të konsiderohen si konkurime të pa përgjegjshme. Fituesi i kontratës obligohet që brenda 100 ditëve kalendarike nga dita e nënshkrimit të kontratës,ta sjell shtatoren dhe ta vendos në postament. Në çmim duhet të kalkulohen të gjitha shpenzimet punimi i bustit, transporti, sigurimi gjatë transportit dhe vendosja në postament,realizuesi i shtatores duhet të shenoj- Gaveroj edhe Emrin Mbiemrin,datën e lindjes dhe te v

DËSHMIJA NGA AK

		konkursit të projektimit. **Identifikimit teknik (dokumentacioni i kërkuar futën në zarfë të veçantë(original dhe kopje).Zarfat të shënohen me kod katërshifror.**
Dokumente që përbëjnë Koncept Projektin	18.1 (a)	*Shtëpi botuese gjera për prezantimin e projektit, p.sh. mundësi elektronike*
Afati i fundit i dorëzimit të tenderit	20.1	Afati i fundit për dorëzimin është **28.08.2020 14:00:00 orë** Vendi: **Drejtoria e Prokurimit , zyra nr.19** **Ofertat dorëzohen ne kopje fizike.**
Vlerësimi i Koncept Projekteve	23.1	Kriteret, nën-kriteret, dhe sistemi i pikëve i cili do të përdorët për vlerësimin e Koncept Projekteve janë:

	Nën-kriteret	Pesha në %
1	1.Kompozicioni artistik i shtatores.	40%
2	2.Shprehja figurative me te cilen reflektohen e tiparet dhe personalitetin e Heroit Kombëtar Adem Jashari.	10%
3	3.Shkalla e integrimit te shtatores ne hapësir ku planifikohet te vendoset (Të prezantohen 3D pamja nga minimum 3 kënde të ndryshme).	10%
4	4.Origjinaliteti.	10%
5	5.Çmimi	30%
	Proporcioni i vlerësimit 70% pikë teknike- zgjidhja artistike , 30% çmimi. Pikët llogaritet duke marr për bazë pikët artistike dhe çmimi	
	Pikët Totale për kriteret 100	

	28.4	Numri dhe vlera e shpërblimeve për të dhënë janë ~~Çmimi 1 – Shpërblehet me kontratë~~ ~~Çmimi 2 – 700 Euro~~ ~~Çmimi 3 – 300 Euro~~
Ankesat	28.3	*Komuna Shtimë nr., Fakir Shaini , nr 50*

OPERATORI EKONOMIK I SHPALLUR FITUES – NUK KA DOREZUAR NENKRITERIN 3 - 3.Shkalla e integrimit të shtatores në hapësir ku planifikohet të vendoset (Të preznetohen 3D pamja nga minimun 3 kënde të ndryshme).

TE BASHKANGJITUR KENI KONCEPT PROJEKTIN I CILI NUK E PLOTESON KUSHTIN E KERKUAR NGA AK , SEPSE NUK ESHTE PARAQITUR NE 3D DHE NE KENDE TE NDRYSHME – por eshte paraqitur veteme me tekst.

Koncepti per shtatorën e komandandit legjendar Adem Jasharit

Adem Jashari figura më emblematike e kombit tonë, frymëzim per të realizuar në një skulpturë. Kjo lëvizje paraqet qëndrimin të pa lënkundur në pragun e shtepisë, qëndrimi i njeriut i cili dha shumë gati terë familjen, njëkohesisht paraqet qëndrimin e një komandanti trim ,bujar me një veshtrim plot bujari, me një vizion per të ardhmen e popullit shqipëtar. Janë paraqitur të gjitha detajet, po ashtu edhe armët të cilat tregojn një pozicion ushtarak. Kjo skulpturë në permasat e kërkuara do te duket edhe më e fuqishme, do te përshtatet me hapësirën dhe do ti rris vlerën sheshit ku vendoset, po ashtu do te jete atraksion per vizitorët.

Kodi 0007

DESHMIA E PARAQITUR NGA OFERTA JONE ME KOD 2408 E KOMPANISE TONE

–PMN SHPK

KONCEPT PROJEKTI – shprehja figurative

KONCEPT PROJEKTI

"NDËRTIMI I SHTATORES SË KOMANDANTIT ADEM JASHARI"

NË KËTË PROJEKT (BOCET) PARAQITET HEROI ADEM JASHARI ME MITROLOZ NË DORËN E DJATHTË NË NJË MOMENT PARA AKSIONIT DUKE STUDIUAR VENDIN NGA DO TË KALOJË ME FORCAT E TIJ, SE KU DO TË RRESHTOHET, PËR TË SULMUAR ARMIKUN. VESHJA I ËSHTË PËRMBAJTUR GARDEROBËS SË TIJ, PALLTO LËKURE DHE PANTALLONA USHTARAKE DHE NJË PISTOLETË NË BREZ. PORTRETI I TIJ ME MJEKËRR E FLOKËT KARAKTERISTIKE, ËSHTË TRAJTUAR MË NJË PLASTIKË NË SHËRBIM TË KARAKTERIT E PSIKOLOGJISË SË TIJ. PËRVEQ MITROLOZIT QË MBAN, AI SHFAQET ME NJË QËNDRIM UDHËHEQËSI, DREJTUESI I KËSAJ LUFTE TË PABARABARTË, E CILA U FITUA FALË LUFTËS DHE SAKRIFICËS SË HERONJËVE DHE DËSHMORËVE TË ATDHEUT, KOSOVËS.

3D PAMJA

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankuesit:

***NENI 6 i LPP-së -04/L-042 i ndryshuar dhe Amandamentuar**

***NENI 7 i LPP-së0 -4/L-042 i ndryshuar dhe Amandamentuar**

***NENI 59 i LPP-së - 04/L-042 i ndryshuar dhe Amandamentuar**

***NENI 60 i LPP-së - 04/L-042 i ndryshuar dhe Amandamentuar**

***NENI 80 i LPP-së - 04/L-042 i ndryshuar dhe Amandamentuar**

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

Kërkesat në DT

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Komisioni i vlerësimit te tenderit ne raportin e vlerësimit te datës 17.09.2020 konstaton se:

LISTA E PLOTË STANDARDE E RADHITJES SË TENDERËVE SIPAS KRITERIT TË DHËNIES

Tenderi i përgjegjshëm me cmimin me te lire

Sipas Nenit 60.1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Kjo listë duhet të largohet nga raporti, në qoftë se kriter për dhënien e kontratës është përcaktuar "Tenderi përgjegjës ekonomikisht më i favorshëm".

Radhë	Lenda / grupi: Ndërtimi i Shtatores së Komandantit Adem Jashari	Çmimi total i ofertës (me TVSH)
1.	N.N.P. "KADOLLI" SHPK, 60016092	68 500,00
2.	Lumjetë Havolli Blakçori B.I., 810050823	69 900,00
3.	P.M.N. SH.P.K., 810800856	69 985,00

DEKLARATË

Komisioni rekomandon për dhënie te kontratës OE i cili ka çmimin me te lirë, pasi që është kriter për dhënie te kontratës.

Eksperti shqyrtues/teknik e konteston deklaratën e komisionit vlerësues nga raporti i vlerësimit i datës 17.09.2020, pasi qe ne këtë aktivitet si kriter për dhënie te kontratës nuk është **çmimi me i lirë** siç theksohet ne këtë raport, por ne baze te NJK dhe DT shihet se kemi te bëjmë me Konkurs Projektimi me pesë nën kritere si ne vijim:

	Nën-kriteret	**Pesha në %**
1	1.Kompozicioni artistik i shtatores.	**40%**

2	2.Shprehja figurative me te cilen reflektohen e tiparet dhe personalitetin e Heroit Kombëtar Adem Jashari.	10%
3	3.Shkalla e integrimit të shtatores në hapësir ku planifikohet të vendoset (Të preznetohen 3D pamja nga minimun 3 kënde të ndryshme).	10%
4	4.Origjinaliteti.	10%
5	5.Çmimi	30%
	Proporcioni i vlersimit 70% pikë teknike- zgjidhja artisitke , 30% çmimi. Pikët llogriten duke marr për bazë pikët artisitike dhe çmimi	

Andaj është i pa bazuar rekomandimi i AK për dhënie te kontratës OE i cili ka çmimin me te lirë, me arsyetimin se është kriter për dhënie te kontratës.

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

/

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

/

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Përgjigje në Pretendimet ankimore (neni 113 i LPP-së) të OE ankues:

PRETENDIMI NR1

Boceti i paraqitur nga operatori ekonomik i shpallur fitues është 68cm i lartë, dhe si i tillë duhet të konsiderohet i papërgjegjshëm duke u bazuar ne kërkesën e mësipërme.

Eksperti shqyrtues/teknik pas verifikimit dhe vlerësimit të pretendimeve të OE ankuesit, e konsideron si **pjesërisht te bazuar** pretendimin ankimor ne lidhje me Bocetin e ofruar nga OE i rekomanduar. Duke marre parasysh përshkrimin e konkursit te projektimit (Detyrën Projektuese) ne NJKP dhe DT, është e theksuar se: **Boceti i paraqitur nga konkuruesit si plastikë skulpturore duhet të jetë 60 cm i lartë, pa bazamentin.** – dhe lartësia prej 68cm është gjatësia nga dyshemeja (me gjithë bazament), ndërsa pa bazament siç kërkohet ne DT, boceti i ofruar nga OE i rekomanduar e plotëson kushtin e gjatësisë.

Por boceti i ofruar nga OE i rekomanduar ka shifrën 2000, ndërsa ne tender ka ofertuar me shifrën 0007. Bazuar ne përshkrimin e konkursit te projektimit (Detyrën Projektuese) ne NJKP dhe DT, është e theksuar se: **Punimi nuk duhet të jetë pjesëmarrës në ndonjë konkurs tjetër apo të jetë ekspozuar në veprimtari të tjera të mëparshme të këtij lloji. Ai duhet të jetë i punuar enkas për këtë konkurs.**
Nga këto fakte konstatohet se boceti me shifrën 2000 i OE te rekomanduar nuk përputhet me ofertën ku e mban shifrën 0007, ose mund te jete bocet i punuar për ndonjë konkurs tjetër, me ç'rast bie ndesh me kërkesën e DT - **Ai duhet të jetë i punuar enkas për këtë konkurs.**

PRETENDIMI NR2

OPERATORI EKONOMIK I SHPALLUR FITUES – NUK KA DOREZUAR NENKRITERIN 3 - 3.Shkalla e integrimit të shtatores në hapësir ku planifikohet të vendoset (Të preznetohen 3D pamja nga minimun 3 kënde të ndryshme).

TE BASHKANGJITUR KENI KONCEPT PROJEKTIN I CILI NUK E PLOTESON KUSHTIN E KERKUAR NGA AK , SEPSE NUK ESHTE PARAQITUR NE 3D DHE NE KENDE TE NDRYSHME – por eshte paraqitur veteme me tekst.

Eksperti shqyrtues/teknik konsideron se ky pretendim është **pjesërisht i bazuar**, pasi qe ne baze te dokumentacionit te ofertës se OE te rekomanduar, është ofruar Koncepti për shtatoren e komandantit legjendar Adem Jashari si dhe 3D pamjet, por nga tre kënde te përafërta (ballore dhe nga njëra anë) dhe jo siç është kërkuar ne nënkriterin Nr. 3 te DT - nga minimun 3 kënde të ndryshme.





Bazuar ne Qëllimin e Konkursit të Projektimit, si dhe duke marre parasysh se kemi te bëjmë me shtatoren e Heroit Kombëtar Adem Jashari, si Ekspert Shqyrtues pa dashur te kontestoj profesionalizmin e anëtareve te jurisë, por me qëllimin me fisnik te vlerësimit sa me te drejtë, nga këndvështrimi im profesional nuk pajtohem me përzgjedhjen e bocetit me shifrën 0007 krahasuar me dy modelet tjera 2408 dhe 1955.

Bazuar ne detyrën projektuese, ku nder te tjera potencohet se: **realizim kreativ-artistik që korospodon me kohën që nga pozicionimi dhe ndërtimi i figurës e deri në detajet e modelimit, siq janë portreti, duart, këmbët, veshja etj)** , boceti i përzgjedhur nga AK nuk i plotëson parametrat e kërkuara ne detyrën projektuese, nuk i ka tiparet faciale te Heroit Kombëtar Adem Jashari, por me shume ngjason me ndonjë hero tjetër te para një shekulli, si p.sh. Qerqiz Topulli, etj.

Ky model i përzgjedhur nga AK nuk asocon me Heroit Kombëtar Adem Jashari, nuk paraqet një model reprezentativ te figurës se Adem Jasharit, nuk shprehë butësinë dhe fisnikërinë qe duhet ta këtë, qe ti rezistoj kohës dhe të jetë monument i pëlqyer edhe nga gjeneratat e reja qe do vinë.

Bazuar ne tre modelet e prezantuara ne këtë konkurs projektimi, nga këndvështrimi im konsideroj se nuk është bërë përzgjedhja e duhur, se ky model nuk e rritë vlerën e sheshit krahasuar me dy modelet tjera.

Bazuar ne çka u tha me lartë, **Eksperti Shqyrtues** konsideron se ky Aktivitet i Prokurimit duhet të kthehet në rivlerësim dhe AK në bazë të kompetencave të tyre të vazhdojë procesin e rivlerësimit konform LPP-së dhe RRUOPP-së, duke i marre për bazë ne mënyrë te drejtë nën kriteret e tenderit si dhe detyrën projektuese te kërkuar ne NJKP dhe DT.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, rrjedhimisht te anulohet propozimi për dhënie te kontratës (Njoftimi mbi Vendimin e AK) dhe Aktiviteti i Prokurimit te kthehet në RIVLERËSIM.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA SHTIME**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **"P.M.N." SH.P.K.**